


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6890
E martë, 9 maj 2023
Çmimi 0.40 €

Begaj: Dialogu Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohje reciproke



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I PARLAMENTIT TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË,
WOLFGANG SOBOTKA, VIZITON KOSOVËN

AUSTRIA VAZHDON TË JETË MBËSHTETËSE E FUQISHME E KOSOVËS NË SUBJEKTIVITETIN NDËRKOMBËTAR



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim homologun nga Austria, Wolfgang Sobotka, me të cilin kanë diskutuar për raportet

ndërshtetërore dhe bashkëpunimin parlamentar. Konjufca ka theksuar se vizita e kryetarit Sobotka është edhe një dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyera, si dhe rikonfirmim i

miqësisë së thellë mes dy shteteve dhe popujve tanë. Ndërkaq kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka, ka shprehur mbështetjen për rrugën evropiane të Kosovës

'NEW YORK TIMES' SHKRUAN MBI LIDHJET E DYSHUARA TË PRESIDENTIT VUÇIQ ME KRIMIN E ORGANIZUAR



MOLLIQAJ: ÇFARË PO FSHIHET NË KEK?

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



ZELENSKY THOTË SE RUSIA DO TË MPOSHTET "SIKURSE U MPOSHT NAZIZMI"

KRYETARI I LDK-së E NIS JAVËN ME VIZITA NË BIZNESE FAMILJARE

TREGUESIT E DHUNËS NË FAMILJE, NË RITJE NË SHOPIËRI

EKONOMI



FORUMI EKONOMIK I VJENËS MBAN KONFERENCËN 'VIENNA ECONOMIC TALKS - PRISHTINA 2023'

ATK-ja MBLEDH RRETH 50 MILIONË EURO MË SHUMË SE NË VITIN PARAPRAK

SPORT



REALI PËRBALLET ME CITYN

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kina dhe ShBA-ja kërkojnë qetësim të raporteve

PEKIN, 8 MAJ - Ministri i Jashtëm i Kinës, Qin Gang, tha më 8 maj se është e domosdoshme të qetësohen raportet në mes të Kinës dhe Shteteve të Bashkuara pas një seri "fjalësh të ashpra dhe veprash".

Qin, gjatë një takimi në Pekin me ambasadorin amerikan Nicholas Burns, tha se ShBA-ja duhet ta përmirësojë trajtimin që i bën çështjes së Tajvanit dhe duhet të ndalojë së mosrespektuari principin "e një Kine".

Raportet midis dy ekonomive më të mëdha në botë u përkeqësuan vitin e kaluar, kur kryetarja e atëhershme e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, vizitoi ishullin vetëqeverisës të Tajvanit, duke zëmëruar Kinën që pretendon se ky ishull është pjesë e territorit të saj.

Në përgjigje, Kina ndaloi disa kanale që përdoren për

komunikime zyrtare me ShBA-në, veçmas ato mes dy ushtrive. "Prioriteti kryesor është stabilizimi i raporteve Kinë - ShBA, të shmangët përkeqësimi i raporteve dhe të parandalohet çdo aksident midis Kinës dhe ShBA-së", tha Qin gjatë takimit me Burns, njoftoi Ministria e Jashtme kineze.

Tensionet midis dy superfuqive u ulën nëntorin e kaluar, kur presidenti amerikan Joe Biden u takua me liderin kinez Xi Jinping gjatë samitit të G20-s në Indonezi dhe udhëheqësit u zotuan për dialog më të shpeshtë.

Por, tensionet u rritën sërish në shkurt kur një balonë kineze u shfaq në hapësirën ajrore amerikane, duke e detyruar sekretarin amerikan të Shtetit, Antony Blinken, që ta anulonte vizitën e tij në Pekin. "Që atëherë, një seri fjalësh të ashpra dhe

veprash nga ShBA-ja kanë minuar momentumin pozitiv, të fituar me mund, në raportet Kinë - ShBA", tha Qin.

Ambasadori Burns përmes një postimi në "Twitter" tha se gjatë takimit me Qin ka folur edhe për nevojën që të ketë qëndrueshmëri në raportet mes dy shteteve. "Ne diskutuam për sfidat në raportet ShBA - Kinë dhe për nevojën e stabilizimit të marrëdhënieve dhe zgjerimit të komunikimit në nivel të lartë", tha Burns.

Tajvani mbetet çështja kyçe në raportet midis Kinës dhe ShBA-së.

Muajin e kaluar Kina mbajti stërvitje ushtarake rreth Tajvanit, pasi presidentja tajvaneze, Tsai Ing-wen, u takua me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, në ShBA.

Që nga viti 1979 raportet ShBA -



Tajvan janë vendosur në bazë të Aktit të Raporteve me Tajvanin, që ofron bazë ligjore për t'i dhënë Tajvanit mjetet e nevojshme për ta mbrojtur veten, por nuk thotë se ShBA-ja do t'i ndihmojë

Tajvanit në rast të ndonjë sulmi. Në buxhetin për vitin 2023, Kongresi amerikan ka autorizuar ndihmë ushtarake për Tajvanin në vlerë prej një miliard dollarësh.

Zelensky thotë se Rusia do të mposhtet "sikurse u mposht nazizmi"

KIEV, 8 MAJ - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u zotua se forcat ruse do të mposhten në Ukrainë sikurse është mposhtur Gjermania Naziste në Luftën e Dytë Botërore. "E gjithë ligësia e së shkuarës, që po risillet nga Rusia moderne, do të mposhtet, ashtu sikurse u mposht nazizmi", tha Zelensky përmes një videomesazhi, që e incizoi duke qëndruar para një memoriali të luftës. "Ashtu sikurse së bashku mposhtëm ligësinë atëherë, së bashku jemi duke mposhtur një ligësi të ngjashme", shtoi ai.

Ky adresim i presidentit ukrainas vjen në përvjetorin e dorëzimit të Gjermanisë Naziste ndaj forcave aleate më 8 maj 1945, dhe një ditë para



Ditës së Fitores, që Moska feston për ta shënuar fitoren e

Bashkimit Sovjetik në Luftën e Dytë Botërore.

Zelensky tha se ka dërguar një projektligj në Parlament për të

shënuar zyrtarisht në Ukrainë më 8 maj Ditën e Fitores në Luftën e Dytë Botërore dhe për festimin e Ditës së Evropës më 9 maj, duke distancuar edhe më tej shtetin e tij nga Moska. Ai tha se Kremlini është përgjegjës "për agresion dhe aneksim, pushtim dhe dëbim", por edhe për "vrasje në masë dhe torturë". "Për të gjitha këto ne do të përgjigjemi me fitoren tonë, fitoren e Ukrainës dhe botës së lirë", tha Zelensky. Adresimi i Zelenskyt vjen disa orë pasi autoritetet ukrainase njoftuan se kanë penguar 35 sulme me dronë të lëshuar nga Rusia dhe pas shtimit të sulmeve ajrore ruse ndaj qyteteve ukrainase, përfshirë edhe Kievin.

Anija misterioze kozmike kineze kthehet në Tokë pas 276 ditësh

PEKIN, 8 MAJ - Një anije eksperimentale kozmike e Kinës është kthyer në Tokë më 8 maj, pasi qëndroi në orbitë për 276 ditë, raportoi media shtetërore kineze. Kthimi i kësaj anijeje u bë pas përfundimit të një misioni të rëndësishëm, që synonte ta testonte teknologjinë e ripërdorshme hapësinore të Kinës.

Kjo fluturake pa ekuipazh u rikthye në qendrën e lëshimit të anijeve në Xhiquan në veriperëndim të Kinës, ashtu siç ishte paraparë, raportoi media shtetërore kineze.

Autoritetet nuk kanë dhënë asnjë detaj se për çfarë anije kozmike bëhet fjalë, çfarë teknologjie është testuar, sa lart ka fluturuar dhe në çfarë trajektore ka fluturuar anija që kur u lëshua në hapësirë në gusht të vitit të kaluar.

Ky testim shënon një arritje "të rëndësishme" për teknologjinë e ripërdorshme të anijeve kozmike të Kinës, që do të ofrojë një mënyrë më të lirë dhe më të përshtatshme për përgatitjen e misioneve të reja hapësinore, raportoi media shtetërore kineze.

Më 2021 një anije e ngjashme kozmike kishte fluturuar në hapësirë dhe ishte kthyer në Tokë në po të njëjtën ditë, por edhe atëbotë autoritetet kineze nuk dhanë detaje të misionit.

Komentatorët në rrjetet sociale kineze kanë speculuar se Pekini po zhvillon një anije kozmike sikurse modeli amerikan X-37B, një avion i pavarur hapësinor që mund të qëndrojë në orbitë për vite të tëra.

Një anije e tillë amerikane u kthye në Tokë nëntorin e vitit të kaluar, pasi kishte qëndruar në orbitë për më shumë se 900 ditë.



'New York Times' mbi lidhjet e dyshuara të presidentit Vuçiq me krimin e organizuar

Revista javore e gazetës 'New York Times' ka botuar një artikull të gjatë, në të cilin zbulon lidhjet e pretenduara të presidentit serb Aleksandër Vuçiq me botën e krimit në Serbi. Artikulli përmban hollësi rreth krimeve të kryera nga një grup kriminal, udhëheqësi i të cilit thotë se i ka shërbyer pushtetit të presidentit Vuçiq. Gazetari Artan Haraqija bisedoi me autorin e artikullit, gazetarin Robert F. Worth dhe profesorin amerikan, njohësin e hershëm të zhvillimeve në Ballkan, Daniel Serwer, të cilët thonë se presidenti Vuçiq ka vënë nën kontroll të gjitha levat e pushtetit në Serbi

PRISHTINË, 8 MAJ - Një artikull i gjatë, i publikuar fillimisht në faqen e internetit të gazetës 'New York Times', ngre akuza të shumta mbi lidhjet e presidentit serb Aleksandër Vuçiq me botën e krimit të organizuar. Artikulli i gazetarit Robert F. Worth përshkruan në hollësi krimet e kryera nga banda e Veljko Belivukut, kreu i grupit të tifozëve të ekipit të futbollit, Partizani i Beogradit. Ai dhe 29 pjesëtarë të grupit u arrestuan më 2021. "Në një seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, Veljko Belivuk tha se banda e tij ishte organizuar 'për nevojat dhe me urdhër të Aleksandër Vuçiqit', sipas transkriptimeve të gjykatës", thuhet në artikullin e 'New York Times'. "Ai përshkroi disa nga punët që banda pretendonte se i kishte bërë për qeverinë, si frikësimi i rivalëve politikë" dhe se ishte takuar personalisht edhe me presidentin Vuçiq. Këto akuza janë hedhur poshtë nga presidenti serb, i cili, megjithatë, refuzoi t'i komentonte akuzat për 'New York Times'.

Gazetari Worth thotë se ai nuk beson se Vuçiqi i ka krijuar bandat kriminale nacionaliste serbe por ai, padyshim, i ka shfrytëzuar ato për forcimin e pushtetit të vet. "Nacionalizmi serb nxit luftën e Jugosllavisë në vitet 1990. Pra, ajo ka ekzistuar për një kohë të gjatë dhe e njëjta gjë mund të thuhet edhe për krimin e organizuar. Unë mendoj se ai është një politikan oportunist që dëshiron shumë të jetë në pushtet. Ai ka qenë shumë efektiv në kontrollin e pothuajse të gjitha levave të pushtetit në Serbi dhe për këtë ai i ka përdorur të gjitha mundësitë në vend", thotë për "Zërin e Amerikës" gazetari i 'New York Times'-it, Robert F. Worth.

Profesori i Universitetit "John Hopkins" dhe vëzhguesi i hershëm i zhvillimeve në Ballkan, Daniel Serwer, shpreh po të njëjtin mendim. "Nuk ka asnjë politikan që në rrethanat aktuale mund të ngrihet në pushtet në Beograd pa një lloj përshtatjeje me krimin e organizuar dhe Shërbimin e Tij Sekret. Kjo është mjaft e qartë. Pyetja është nëse Vuçiqi është pjesë e problemit, apo pjesë e zgjidhjes. Dhe në tërësi, jam i bindur se ai është pjesë e problemit për shkak të mënyrës se si sillet. Ai ka rivendosur autokracinë në Serbi dhe ka toleruar jo vetëm bandat e futbollit, por edhe të krimit të organizuar", thotë për "Zërin e Amerikës", profesori Daniel



Serwer.

Grupi i Veljko Belivukut ishte arrestuar edhe më parë, por në të gjitha rastet kishte arritur t'i shmangte dënimet për shkak të lidhjeve që deri në vitin 2021 dyshohej se ekzistonin mes tij dhe shtetit serb. "Mbështetja që Belivuk dhe miqtë e tij morën nga policia dhe Ministria e Brendshme gjatë dekadës së fundit është dokumentuar në dëshmitë e gjykatës, përgjimet telefonike dhe fotografitë. Sugjerimi se e gjithë kjo mund të kishte ndodhur pa dijeninë e Vuçiqit shkakton të qeshura në Beograd", shkuan 'New York Times'.

Zyrtarisht kundër grupit të Veljko Belivukut rëndojnë akuza për krime të ndryshme përfshirë edhe disa krime monstruoze si prerja e gjymtyrëve të viktimave, kryesisht pjesëtarë të grupeve rivale kriminale. Pas masakrimit, pjesët e trupave të gjymtuar, siç njofton artikulli i 'New York Times'-it, janë hedhur në një makinë për grirje mishi.

Ministria e Brendshme e Serbisë ka publikuar një video në platformën "YouTube" ku thotë se përpos armëve dhe eksplozivit të grupit të Belivukut gjatë bastisjeve, ka gjetur edhe makinën e mishit me ADN-në e viktimave që dyshohet se janë masakruar.

Ndërsa Vuçiqi, sipas artikullit të 'New York Times'-it, ushtron kontroll mbi pothuajse çdo

aspekt të jetës publike, arrestimi i grupit të Belivukut mund të jetë një nga vendimet e pakta që presidenti serb nuk e kontrolloi dot.

Provat në këtë rast erdhën nga një ekip belg i EUROPOL-it i cili pas dy vjetësh përpjekjeje arriti ta deshifrojë aplikacionin për mesazhe telefonike Sky - ECC, një mjet i preferuar komunikimi i trafikantëve të kokainës në Evropë. Aty u zbuluan të gjitha të dhënat për grupin e Veljko Belivukut, një gjë që autoritetet në Serbi nuk mund ta shmangin më. Gazetari amerikan thotë se ai pret që hetimi i EUROPOL-it, i cili ende vazhdon, të zbulojë lidhje kriminale ndër grupe të ndryshme etnike në Ballkan. "Ky hetim evropian i drejtuar nga Europol zbuloi vërtet këto rrjete kriminale në një mënyrë që nuk ishte bërë kurrë më parë. Ata ende po i hetojnë mesazhet që i deshifruan. Pra, mendoj se ka shumë të tjera që nuk janë raportuar ende. Një gjë që vlen të përmendet është se këto dallavere kriminale e tejkalojnë shpesh politikën. Njerëzit mund të jenë në anë të ndryshme etnike, por kur bëhet fjalë për para, ata do të bashkëpunojnë. Unë mendoj se ne do të zbulojmë më shumë me kalimin e kohës për mënyrën se si funksionojnë këto rrjete kriminale", thotë gazetari Worth.

Artikulli i tij thotë se deri më tani shumica e të dhënave nga

Ballkani kishin të bënin me grupin serb.

Artikulli i 'New York Times'-it disa herë përmend edhe rrezikun që presidenti serb mund të nxisë një luftë me qëllim krijimin e Botës Serbe, ideja nacionaliste e kontrollimit të të gjitha territoreve ku jetojnë serbët. Kjo nënkupton edhe dërgimin e ushtrisë për aneksimin e veriut të Kosovës.

Sipas 'New York Times'-it, ky shqetësim mban zgjar natën diplomatët evropianë. Sidoqoftë, evropianët, krahas zyrtarëve amerikanë, sipas analistit, Daniel Serwer, vazhdojnë të ofrojnë përkrahje të palëkundur për qeverinë serbe dhe në përgjithësi autokratët në Ballkan. "Zyrtarët perëndimorë janë duke e mashtruar veten dhe këtë po e bëjnë për një qëllim. Ata kanë hequr dorë nga demokracia liberale në Serbi, në Kosovë, në Bosnjë, në përgjithësi në Ballkan. Dhe ajo që ata po bëjnë është të përpiqen t'i përdorin nacionalistët për ta ruajtur paqen, në thelb, për ta stabilizuar rajonin. Kjo është një ide që ka ekzistuar gjithmonë në Perëndim, por është bërë shumë e spikatur në administratën e presidentit Biden dhe ajo anon shumë drejt të qenit pozitiv për Beogradin, pa marrë parasysh çfarë ndodh", thotë për Zërin e Amerikës, profesori i Universitetit "John Hopkins", Daniel Serwer. Gazetari amerikan Robert F.

Worth thotë se ka serbë që mendojnë se situata në përgjithësi është edhe më keq sesa në kohën e Sllobodan Millosheviqit.

"Disa serbë më ka thënë që në disa forma situata është më keq sesa që ishte në kohën e Millosheviqit. Drejtësia është më e politizuar sesa ishte në atë kohë. Nuk ka luftë civile të përgjakshme më dhe kjo është një gjë e mirë, por Serbia tani është një vend ku policia, në disa nivele dhe në kohë të ndryshme, ka qenë e përfshirë në aktivitete kriminale", thotë Worth. Gazetari thotë se ai nuk është ndaluar asnjëherë sa ishte në Serbi, ndonëse nuk e përjashton mundësinë që të jetë përgjuar pa e kuptuar. "Nuk e kam përmendur këtë në artikull, por kam pasur një takim me një ish-funksionar të lartë të policisë serbe, i cili donte të më jepte disa informacione, por ishte shumë i frikësuar për pasojat. U takuam në një kafeteri dhe brenda pak minutash ai tha se po na vëzhgojnë dhe nuk jemi të sigurt. Bëra përpjekje ta kontaktoja sërish dhe t'i ofroja siguri që të fliste, për të më treguar ato që kishte për të thënë, por ai vendosi të mos fliste më".

Të njëjtën ndjenjë përgjimi, tregon gazetari, pati edhe ish-presidenti Boris Tadiq, i cili në një takim me të, iu afrua pranë duke i pëshpëritur "disa miq të Belivukut mund të jenë ulur pranë nesh". /Voa



KRYETARI I PARLAMENTIT TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, WOLFGANG SOBOTKA, VIZITON KOSOVËN

Austria vazhdon të jetë mbështetëse e fuqishme e Kosovës në subjektivitetin ndërkombëtar

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim homologun nga Austria, Wolfgang Sobotka, me të cilin kanë diskutuar për raportet ndërshtetërore dhe bashkëpunimin parlamentar. Konjufca ka theksuar se vizita e kryetarit Sobotka është edhe një dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyera, si dhe rikonfirmim i miqësisë së thellë mes dy shteteve dhe popujve tanë. Ndërkaq kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka, ka shprehur mbështetjen për rrugën evropiane të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i Parlamentit të Republikës së Austrisë, Wolfgang Sobotka, ka ardhur për vizitë të hënën në Kosovë. Konjufca, i cili doli për ta pritur në Aeroportin e Prishtinës, tha se ishte kënaqësi e veçantë ta mirëpriste në Kosovë mikun tonë të çmuar, kryetarin e Parlamentit të Republikës së Austrisë, Wolfgang Sobotka.

Ai ka theksuar se vizita e kryetarit Sobotka është edhe një dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyera si dhe rikonfirmim i miqësisë së thellë mes dy shteteve dhe popujve tanë. "Austria mike dhe partnere e besueshme vazhdon të jetë mbështetëse e fuqishme e Republikës së Kosovës në rrugëtimin e saj euroatlantik dhe forcimin e subjektivitetit

ndërkombëtar. Kontributi i Austrisë për Kosovën është i madh dhe i shumanshëm. E vlerësojmë lart dhe jemi gjithmonë mirënjohës. Po ashtu mbetemi të përkushtuar për forcimin e partneritetit, thellimin e bashkëpunimit dhe avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet shteteve tona", ka deklaruar Konjufca.

Ndërkaq kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka, ka shprehur mbështetjen për rrugën evropiane të Kosovës. Duke folur për dialogun Kosovë - Serbi, ai tha se marrëveshja e Ohrit është shumë e rëndësishme dhe se dy palët duhet ta zbatojnë atë. "Sfiduese është situata e tanishme në Kosovë dhe marrëdhëniet me Serbinë janë një prej sfidave që duhet të zgjidhen gjatë rrugës së dialogut dhe ne çdoherë do të përpiqemi

që për të dyja shtetet të ofrojmë një mundësi që t'i afrohen një hap më tutje njëri-tjetrit. Edhe marrëveshja e Ohrit është shumë e rëndësishme dhe shpresojmë që të dy shtetet të bëjnë një interpretim të njëjtë të kësaj marrëveshjeje dhe këto do të japin mundësinë të planifikojnë edhe për të ardhmen. Austria

edhe në këtë aspekt mund të jetë shembull për Kosovën, nëse mendoni edhe për historinë e shekullit 20", ka deklaruar ai.

Si zgjidhje, ai përmendi edhe Tirolin Jugor, ku mund të arrihet një zgjidhje kompromisi. "Tirolin Jugor ka treguar se si përmes rrugës së dialogut mund të arrijmë një rezultat të mirë. Kjo mund të vlejë edhe për komunat me shumicë serbe në Kosovë", ka pohuar Sobotka.

Kryeparlamentari i Austrisë ka shtuar se Kosova është zhvilluar shumë vitet e fundit, e Austria është investitorja e katërt më e madhe në Kosovë. "Për mua është vizita e dytë në Kosovë, një shtet mik, me një histori kaq të madhe,

në një shtet me shumë përvojë të gjatë historike që rrugën e ka në integrim në BE. Kemi shkëmbyer edhe administratat tona. Një gjë duhet të jetë e qartë, se mirëqenia e mirë dhe sundimi i ligjit është bazë e demokracisë. Jemi investitori i katërt më i madhe këtu në Kosovë", ka deklaruar Sobotka.

Konjufca, duke folur për luftën në Ukrainë dhe mosdënimin e agresionit rus nga Serbia, u shpreh i shqetësuar se Serbia po e destabilizon jo vetëm Kosovë, por edhe rajonin. "Me kryetarin Sobotka i ndamë edhe shqetësimet tona në lidhje me sfidat që i ka bota dhe rajoni. Folëm edhe për agresionin e Ruisë. I shpjegova se shteti i Kosovës e ka dënuar agresionin e Ruisë dhe është në përputhje me BE-në në përkrahje të lirisë dhe sovranitetit të Ukrainës. Ia ngrita shqetësimin për sjelljen e papranueshme të shtetit serb jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon", ka thënë Konjufca.

Ai ka theksuar se Kosova me shumë vullnet të mirë e pranoi marrëveshjen e arritur në Ohër, por tha se janë dëshmitarë se Serbia e lexon ndryshe marrëveshjen nga ajo që e lexon Kosova.



Lajçaku: Drafti i parë për Asociacionin nuk është përfundimtar, pikënisje për diskutimet e ardhshme

PRISHTINE, 8 MAJ - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka qëndruar për vizitë në Zvicër. Ai e ka takuar diplomaten Livia Leu me të cilën ka diskutuar për ecurinë në procesin e dialogut. Gjatë këtij takimi Lajçaku e ka vlerësuar me rëndësi takimin e nivelit të lartë në Bruksel në mes të kryeministrit të Kosovës dhe presidentit serb. "Presidenti Vuçiq dhe kryeministri Kurti u takuan në Bruksel për të diskutuar një çështje vendimtare të personave të zhdukur. Jam i kënaqur që të dy udhëheqësit ranë dakord të punojnë së bashku për ta sqaruar vendndodhjen e njerëzve që u zhdukën gjatë luftës. Ne e mirëpresim miratimin e palëve të deklaratës për

personat e zhdukur dhe presim që ato të bëjnë përpunim në mbylljen e rasteve të pazgjidhura të personave të zhdukur. Kjo jo vetëm se do t'i ndihmojë familjet e tyre të gjejnë paqe, por edhe do ta avancojë normalizimin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar Lajçaku.

Lajçaku theksoi se drafti i paraqitur nga ekipi menaxhues është pikënisje e rëndësishme për diskutimet e ardhshme. "Palët, gjithashtu, bënë një hap të rëndësishëm dhe simbolik drejt themelimit të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe. Megjithatë drafti i parë i paraqitur nga ekipi menaxhues nuk është përfundimtar, ai është një pikënisje e rëndësishme për



diskutimet e ardhshme në nivelin e kryenegociatorëve", u shpreh Lajçaku.

Ekipi Menaxhues për hartimin

e draftit për statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është shkarkuar ditë më parë nga

Qeveria e Kosovës. Drafti i parë i paraqitur është cilësuar i papranueshëm për Kosovën nga kryeministri Albin Kurti.

Begaj: Dialogu Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohje reciproke

TIRANË, 8 MAJ - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, ka pritur të hënën një përfaqësi të Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë, të kryesuar nga presidenti i këtij këshilli, ambasadori Timothy A. Chorba. Kjo përfaqësi e ish-diplomatëve të lartë amerikanë po viziton Shqipërinë në kuadër të një ture rajonal faktmbledhës për tre vende të Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Pasi i vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera të partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe pasi shprehu mirënjohje për atë çka kanë bërë për pavarësinë e Shqipërisë e të Kosovës, presidenti Begaj i njoftoi ish-diplomatët amerikanë me reformat dhe hapat e ndërmarra për konsolidimin e institucioneve demokratike e të shtetit ligjor.

Në mënyrë të veçantë,



presidenti Begaj u ndal te kontributi i Shqipërisë për paqen, stabilitetin dhe ndërtimin e frymës së fqinjësisë së mirë në rajon, duke nënvizuar më tej edhe mbështetjen që Shqipëria i jep

dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si e vetmja alternativë për arritjen e një marrëveshjeje ndërkombëtarisht të detyrueshme, me qendër njohjen e ndërsjellë të tyre. Ndërsa lidhur me procesin e

integritit evropian, presidenti Begaj u shpreh se pas anëtarësimit në NATO, anëtarësimi në Bashkimin Evropian mbetet prioriteti strategjik më madhor i Shqipërisë dhe i shqiptarëve.

Duke iu referuar kushteve të reja gjeopolitike pas agresionit rus në Ukrainë, Begaj nënvizoi qasjen e re të Bashkimit Evropian ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor si dhe i njoftoi të pranishmit me çeljen e negociatave të aderimit nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimeve në Ukrainë, rolit dhe kontributit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në dënimin e agresionit rus dhe në mbrojtje të parimeve të Kartës së OKB-së, gjithashtu dhe rendit botëror.

Më tej presidenti Begaj përsëriti edhe bashkëpunimin e Këshillit të Ambasadorëve Amerikanë me partneren e saj në Shqipëri, Këshillin e Ambasadorëve Shqiptarë, të drejtuar nga presidenti i këtij këshilli, Besnik Mustafaj.

Kryetari i LDK-së nis javën me vizita në bizneset familjare

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abixhiku, ka nisur javën me vizita në bizneset familjare. "Javën e fillon me ciklin e vizitave në biznese familjare. Vizitova sot profesor Alixhemal Ibrahimimin dhe djalin e tij Ervinin, të cilët tash e tre vjet merren me përpunimin e arroveve, kryesisht lajthive, në biznesin e tyre familjar "Pelini's". I pari profesor i gjuhës shqipe, i dyti, magjistër i shkencave politike

në Norvegji. Të dy, babë e bir, të përkushtuar në biznesin familjar të ri. Me plantacionin e tyre në Novobërdë e me shitoren e tyre në Ulpianë, ky biznes familjar arrin të prodhojë produkte vendore të shëndetshme - nga gjalpi e deri te vaji i lajthisë. Potenciali i tyre i rritjes dhe i eksportit është marramendës", ka theksuar Abixhiku.

Ai ka thënë se në këto takime po i kuptojnë sfidat e çdo biznesi - të madh e të vogël në Kosovë - sikurse ky sot.

"Shuarja e burokracisë, nxitja e punimit të tokës, nxitja e mbjelljeve, vjeljeve e grumbullimit të produkteve - më pas përpunimi e brendimi i tyre për tregje deri në Evropë - do të jenë disa nga politikat tona në sektorë. Në Kosovë ka pasur gjithmonë biznese familjare. Ato kanë qenë gjithmonë shpirti i ekonomisë vendore. Janë mbajtur familje, janë shkolluar fëmijë dhe i është dhënë mjaft shoqërisë. Tek to duhet ta kthejmë fokusin



politik sot. Politikat e tjera, të ankimit në të shkuarën, sharjeve e fyerjeve, nuk bëjnë

zgjdhje sot. Kosova mundet më shumë", është shprehur Abixhiku.



Fillojnë procedurat për ndërtimin e parkingut nëntokësor në Podujevë

PODUJEVË, 8 MAJ - Komuna e Podujevës ka filluar procedurat për ndërtimin e parkingut nëntokësor. Projekti i parkingut nëntokësor parashihet të ketë rreth 10 mijë metra katror parking,

po ashtu e ka të inkuadruar edhe hapësirën ku janë destinuar rreth 1 000 metra katrorë për afarizëm. Ky projekt do të realizohet përmes partneritetit publiko-privat.

Në nderim të jetës dhe veprës së heroit komandant 'Drinit', Totaj bën homazhe

PRIZREN, 8 MAJ - Në nderim të jetës dhe veprës së heroit, Ekrem Rexha - komandant "Drini", kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me familjarët e dëshmorit, zyrtarë të ekzekutivit dhe komunalë, asamblastë dhe shoqata të luftës së UÇK-së, kanë bërë homazhe në

varrezat e dëshmorëve në Landovicë në 23-vjetorin e ndarjes nga jeta të komandantit të UÇK-së.

Homazhe u bënë edhe pranë memorialit të komandant "Drinit" në qendër të qytetit. "I përhershëm kujtimi për Ekrem Rexhën!", ka thënë kryetari Totaj.



Haradinaj takohet me ambasadorin turk, e falënderon për mbështetjen e Turqisë



PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim njoftues ambasadorin e ri të Turqisë në Prishtinë, Sabri Tunç Angılı.

Haradinaj ka vlerësuar lart marrëdhëniet në mes dy vendeve si dhe solidariteti i shprehur nga Kosova për ndihmë popullit turk pas tërmetit shkatërrues, është dëshmi për marrëdhëniet e sinqerta. "Prita në takim njoftues ambasadorin e ri të

Turqisë në Kosovë, z. Sabri Tunç Angılı, me të cilin diskutuam për zhvillimet në Kosovë dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve. Duke e uruar z. Angılı për detyrën e re, vlerësova lart marrëdhëniet e shkëlqyeshme mes dy vendeve tona. Solidariteti i shprehur i Kosovës dhe gatishmëria për t'i dalë në ndihmë popullit turk pas tërmetit shkatërrues të cilin e përjetoi, është dëshmi për marrëdhëniet tona të sinqerta që kemi si dy shtete mike", ka shkruar Haradinaj në

"Facebook".

Haradinaj ka falënderuar ambasadorin dhe shtetin turk për mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën, veçmas për pranimin e aplikimit në Këshillin e Evropës. "Njëkohësisht, ambasadorit i shpreha falënderimin për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë për Kosovën në proceset integruese, siç ishte rasti së fundmi për pranimin e aplikimit të Kosovës në Këshill të Evropës, por edhe në procese të tjera integruese që na presin", ka shkruar Haradinaj.

Një person në Ferizaj bleu ushqime 740 euro me monedha dyshe të falsifikuara

FERIZAJ, 8 MAJ - Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se më 7 maj, rreth orës 15:00, ka pranuar një informacion se në rrugën magjistrale Ferizaj - Prishtinë, te një qendër tregtare në Ferizaj, një person i dyshuar aty kishte blerë produkte ushqimore në vlerë rreth 740 euro, të gjitha monedha nga dy (2) euro të dyshuara si të falsifikuara dhe ishte larguar. Policët e rendit, më pas edhe

policët hetues, menjëherë i janë përgjigjur kësaj informate dhe nën autorizim të prokurorit kujdestar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, i kanë nisur hetimet. "Pas një pune intensive hetimore, grumbullimit të informacioneve në terren, shikimit të kamerave të sigurisë, është identifikuar dhe është shoqëruar në Stacionin e Policisë në Ferizaj personi i

dyshuar H. R. (M/K), i moshës 41-vjeçar. Pas intervistimit të tij nga policët hetues, me vendim të prokurorit të rastit i njëjti është liruar në procedurë të rregullt hetimore, kurse monedhat në vlerë 740 euro, të gjitha monedha nga dy (2) euro, janë konfiskuar për procedura të mëtejme hetimore. Rasti është cilësuar 'Falsifikim i parasë', ka njoftuar Policia e Kosovës.



Kryetari i Prishtinës inspekton punimet e tri rrugëve në kryeqytet

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka inspektuar punimet e rrugëve në kryeqytet

"Nekibe Kelmendi", "Xheladin Rekalii" dhe "Kodra e Trimave". Ai ka thënë se në këto rrugë po bëhen punime të mëdha.

"Inspektimi ynë iu kushtua kërkesave dhe nevojave të banorëve të këtyre zonave për të siguruar një mjedis të pastër

dhe të sigurt për të gjithë. Ne vazhdojmë ta zhvillojmë kryeqytetin", ka thënë kryetari Rama.



Molliqaj: Çfarë po fshihet në KEK?

PRISHTINË, 8 MAJ - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka vendosur gjobë në vlerën prej 3.2 milionë eurosh për Korporatën Energjetike të Kosovës dhe 439 mijë euro për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT). Vendimi është marrë javën e kaluar, në seancën e Bordit IV me radhë për këtë vit. Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, e ka komentuar këtë vendim, duke theksuar se KEK-u ka bërë tregti me një kompani ilegale. "KEK-u është

gjobitur nga ZRRE me 3.2 milionë euro gjobë, sepse ka tregtuar energji elektrike me kompani që nuk janë të licencuara për operim në Kosovë. Pra KEK-u ka bërë tregti me një kompani ilegale. Ky do të duhej të ishte material shtesë për prokurorinë. Sepse në këtë formë janë bërë një sërë shkeljesh duke dëmtuar kompanitë e licencuara", ka shkruar Molliqaj në "Facebook". Molliqaj ka bërë me dije se i kanë drejtuar pesë pyetje ZRRE-së. "Pse janë

përzgjedhur kompani të palicencuara për të tregtuar energji? Sa është sasia e tregtuar e energjisë me kompanitë e palicencuara? Sa është kostoja financiare e këtij tregtimi? Kush janë kompanitë e palicencuara me të cilat KEK ka tregtuar energji? Këto çështje dhe të tjera që kemi ngritur do ta zbardhin edhe më shumë korrupsionin dhe keqmenaxhimin e theksuar në këtë sektor", ka shkruar kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj.



Treguesit e dhunës në familje, në rritje në Shqipëri



TIANË, 8 MAJ - Treguesit e dhunës në familje po shënojnë rritje vit pas viti në Shqipëri duke e bërë këtë dukuri gjithnjë e më shqetësuese për shoqërinë dhe autoritetet vendore dhe kombëtare. Sipas statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale në Shqipëri në vitin 2022 u shënuan rreth 1 880 raste të dhunës në familje me mbi dy mijë autorë të kësaj vepre penale. Në Qarkun e Gjirokastrës autoritetet gjyqësore po u kërkojnë qytetarëve të jenë më aktivë në denoncimin e rasteve të dhunës, ndërsa strukturat vendore po bëjnë përpjekje t'i rritin shërbimet ndaj viktimave të dhunës. Pak ditë më parë në një takim me gazetarë dhe struktura vendore të mbrojtjes sociale nënkryetarja e Gjykatës së Gjirokastrës, Suelda

Dashi, solli në vëmendje se pothuajse të gjitha rastet e dhunës në familje paraqiteshin në gjykatë nga komisaritet e policisë. Dashi tha se vetë qytetarët mund të bënin padi për rastet e dhunës direkte në gjykatë për të pasur veprime të menjëhershme. "Jo çdo gjë mund të vijë nga komisariti. Vetë qytetarët duhet të edukohen që t'i drejtohen vetë gjykatës me kërkesë-padi. Sepse mund të ndodhë që për shkak të burokracive, komisaritet mund të vonojnë me ditë apo me orë dërgimin e denoncimeve, por në rastet e dhunës në familje kjo kohë mund të jetë fatale. Mjafton që qytetarët të drejtohen në kryesekretarinë e gjykatës dhe të paraqesin një kërkesë-padi në formë shkresore dhe pastaj është gjykata ajo që investohet e tëra në marrjen në shqyrtim të rasteve".

Dashi tha se gjatë vitit 2022 Gjykata e Gjirokastrës dha 70 urdhra mbrojtjeje për raste të denoncimit të dhunës, ndërkohë që në vitin 2021 u dhanë 20 urdhra mbrojtjeje për dhunën ndaj grave dhe të miturve. Sipas statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale, në Shqipëri rastet e dhunës në familje janë rritur vit pas viti. Në vitin 2022 u shënuan 1 887 raste të dhunës në familje nga 1 631 që ishin shënuar në vitin 2021 dhe 1 374 në vitin 2018. Edhe numri i autorëve për këto vepra penale ka ardhur në rritje. Sipas statistikave zyrtare, në vitin 2022 në Shqipëri për dhunën në familje janë 2 003 autorë nga 1 733 që ishin në vitin 2021 dhe 1 459 që ishin në vitin 2018. Rastet e dhunës në të shumtën e herës denoncohen me vështirësi, thotë Loreta Mamani,

përfaqësuese e Urdhrit të Psikologut në Gjirokastrë. "Vihet re që dhuna nuk denoncohet menjëherë në rastet e para, por ajo zgjat sepse ndodh brenda katër mureve të familjes. Të miturit, nëna, kanë gjithmonë shpresë se babai që ushtron dhunë do të rregullohet, do të përmirësohet gjendja, por kur kalon shumë kohë që personi e vazhdon këtë dhunë, atëherë bëjnë denoncimin në polici", thotë ajo. Bashkëtë kanë krijuar struktura të posaçme për këto kategori dhe në Gjirokastrë funksionon edhe një qendër e trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Erjona Shkrepa, psikologe pranë kësaj qendre, flet për shërbimet që afrohen: "Qendra ofron shërbim psikologjik, këshillim dhe mbështetje psiko-sociale. Ofrojmë

akomodim 72 orë për rastet e dhunës, mbështetje me ndihmë ekonomike me një paketë prej 9800 mijë lekësh, i mbështetim fëmijët e të dhunuarave me kopshte dhe çerdhe falas si dhe ofrojmë shërbim juridik falas për rastet që paraqiten në qendër. Shkrepa thotë se rastet më të shumta të denoncimit të dhunës vijnë nga zonat urbane dhe nga familje me nivel të ulët ekonomik. "Rastet që paraqiten vijnë nga familjet me ekonomi të ulët. Ndoshta ndikojnë shkollimi i ulët, ekonomia. Janë shumë faktorë që ndikojnë në dhunën në familje". Në Shqipëri fenomeni i dhunës, sidomos ndaj grave, vajzave dhe të miturve, mbetet sfida për autoritetet dhe shoqërinë jo vetëm prej treguesve në rritje, por edhe thellimit të varfërisë, sidomos në zonat rurale.

FSK-ja përfundon ushtrimin fushor "Steel Alpha 2023"

PRISHTINË, 8 MAJ - Në kuadër të përgatitjeve për ushtrimin "Defender Europe 2023" është realizuar ushtrimi

fushor "Steel Alpha 2023" për validimin e kompanisë A dhe Togut IVR nga Regjimenti i Dytë i Forcave

Tokësore. Në këtë ushtrim janë kryer stërvitje për operacione të mbrojtjes, sulmuese, të sigurisë dhe

stabilitetit, duke i përfshirë këtu edhe stërvitjet në nivel kompanie (LFX), me të gjitha sistemet e armatimit.



Nagip Krasniqi mbetet në paraburgim, Apeli refuzon ankesën e mbrojtjes

PRISHTINË, 8 MAJ - Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e palës mbrojtëse për ta pezulluar masën e paraburgimit ndaj kryshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqi. Lajmin për "Telegraf"-in e ka konfirmuar zëdhënësi i Gjykatës së Apelit, Nysret Arifi. "Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e palës mbrojtëse dhe i pandehuri Nagip Krasniqi mbetet në paraburgim, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Special PPPS, nr. 20/2023, i datës 20.04.2023, vërtetohet", ka thënë Arifi.

Mbrojtja ka kërkuar që Krasniqi të lirohet nga paraburgimi dhe atij t'i caktohet një masë më e butë me qëllim që ta sigurojë praninë e tij në procedurën penale si dhe në të njëjtën kohë, të respektohen parimet themelore të drejtësisë. Gjykata Themelore e Prishtinës ia ka caktuar një muaj paraburgim kryshefit të KEK, Nagip Krasniqi, pasi dyshohet për kryerjen e tri veprave penale. Krasniqi u arrestua më 19 prill nën dyshimin e keqpërdorimit të pozitës

zyrtare, ushtrimin të ndikimit dhe konfliktit të interesit. "Gjatë bastisjes janë sekuestruar dokumente të ndryshme që ndërlidhen me rastin, pajisje elektronike si tre (3) kompjuterë, një (1) laptop, një (1) celular, një (1) USB, në cilësi të provave materiale që do të shërbejnë për procedurën e mëtejme", kishte njoftuar prokuroria. Disa ditë më vonë Bordi i Drejtorëve të KEK-ut mori vendim për pezullimin e Nagip Krasniqit nga detyra e punës së kryshefit ekzekutiv, me efekt të menjëhershëm.



Forumi Ekonomik i Vjenës mban konferencën 'Vienna Economic Talks - Prishtina 2023'



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 MAJ - Nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, të hënën në Prishtinë, për herë të parë, Forumi Ekonomik i Vjenës po mban konferencën Vienna Economic Talks - Prishtina 2023.

Kryeministri Kurti ishte folës kryesor në sesionin hyrës, me ç'rast u uroi mirëseardhje të gjithë të pranishmëve dhe i njoftoi ata për përparimin dhe arritjet në dy vitet që po lëmë

pas dhe për synimet e përbashkëta për vitet që na presin në të ardhmen.

Në këtë ngjarje kryeministri Kurti, në emër të Republikës së Kosovës, në 15-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimit të Kosovës në këtë forum, pranoi çmimin nga Forumi Ekonomik i Vjenës për bashkëpunim dhe kontribut të shkëlqyeshëm në zhvillimin ekonomik të nivelit nacional dhe rajonal, çmim ky që u dorëzua nga presidenti i Forumit Ekonomik, ambasador Victor Jackovich.

Në fjalën e tij falënderuese, kryeministri Kurti bëri thirrje edhe për më shumë bashkëpunim, ashtu që slogani i Forumit Ekonomik të Vjenës "Shkoni në juglindje" (Go South East), të bëhet sinonim me 'nearshoring' (western nearshoring).

Kurti ka thënë se qeveria të cilën ai e drejton parasheh zhvillimin e energjisë së ripërtërishtme në 10 vitet e ardhshme. Ai ka përmendur edhe marrëveshjen e fundit me FMN-në, e cila do të

përdoret për energjinë e rinovueshme.

"Një marrëveshje e fundit me FMN-në na jep 80 milionë euro për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë së rinovueshme dhe solare. Me Strategjinë tonë të Energjisë 2022-2031 ne parashikojmë për më pak se 10 vitet e ardhshme me shumë se 1 300MWh të gjeneruara nga burimet e rinovueshme", ka theksuar Kurti.

Kryetari i Forumit Ekonomik të Vjenës, Victor Jackovich, është shprehur se Kosova është pjesë integrale e Evropës. "Sot ju keni

një ekonomi të gjallë. Ka shumë sfida që përballeni, edhe presione do të thosha prej shumë vendeve të ndryshme, pra nga kudo. Ju keni një demokraci sepse keni mbështetjen e popullit tuaj, pra ju jeni në gjendje t'i përballoni këto sfida dhe t'i kapërceni ato", tha Jackovich. Përgjatë tri sesioneve përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare do të diskutojnë për bashkëpunimin rajonal në fushën e investimeve përmes inovacionit teknologjik.

ATK-ja mbledh rreth 50 milionë euro më shumë se në vitin paraprak

PRISHTINË, 8 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se për periudhën raportuese janar - prill 2023 ka arritur të mbledhë te hyra 47.7 milionë euro apo 17.7 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

ATK-ja ka njoftuar se rritja e këtyre statistikave siguron arkën e shtetit që janë inkasuar në total 317.1 milionë euro tatime dhe 83.6 milionë euro kontribute pensionale, që në total tatime+kontribute janë 400.7 milionë euro. "Vazhdimi i performancës së

mirë të mbledhjes së të hyrave tatimore është rezultat i përkushtimit maksimal të të gjithë stafit të ATK-së, si dhe trajtimi specifik i sektorëve të cilët, sipas parametrave dhe analizave të ATK-së, shkaktojnë mospërmbushje tatimore", ka njoftuar ATK-ja.



Ku dallon të qëndruarit vetëm nga vetmia



Nga Jonny TOMSON

S'ka nevojë të qëndrosh vetëm për t'u ndjerë i vetmuar. Imagjinoni për një moment 2 njerëz të ulur në të njëjtën kafene. Dikush mund të ndihet shumë i angazhuar, duke dëgjuar muzikën në sfond, kontrolluar postën e tij elektronike, apo duke parë njerëzit gjatë konsumit të gjellnjave të kafesë.

Ndërkohë tjetri mund të ndihet jashtëzakonisht i vetmuar, i vetëdijshëm se sa shumë i mungon dikush për ta ndarë atë kohë që po kalon. Ky person e sheh botën jo si një spektakël, por me një dhimbje të madhe. Ekziston një dallim thelbësor midis të qenit vetëm dhe vetmisë, dhe që të dyja janë ndjenja shumë të ndërlikuara.

Në çdo ditë të caktuar, ne të gjithë duhet të kalojmë shumë kohë vetëm me veten tonë, dhe brenda kokës tonë. Kjo është një pjesë normale e jetës. Por kur kjo rutinë shndërrohet në vetmi? Filozofi gjerman Artur Schopenhauer quhet ndonjëherë edhe 'filozofi pesimist', pasi ai thoshte se "jeta lëkundet si një lavjerrës midis dhimbjes dhe mërzi".

I frymëzuar nga leximi i tekstit hindu, Upanishads, ai besonte se burimi i gjithë mjerimit të jetës vjen nga dëshirat tona të pandërprera dhe të

pamëshirshme. Pra të jesh i vetmuar, do të thotë të dëshirosh diçka që të mungon. Do të thotë të ndjesh brenda teje një zbrazëti e cilambetet e pambushur, të ndihesh i izoluar, në nevojë ose i braktisur, por pa askënd që mund të të ndihmojë.

Ndërkohë të qëndruarit vetëm është një gjë tjetër. Ajo nënkupton të tërhiqesh në vetvete dhe të kënaqesh shumë në shoqërinë e vetes tënde. Kur jemi të vetmuar, ne mund të mendojmë lirisht dhe të jemi aq të ndershëm sa të duam. Vetëm kur jemi të shpërqendrimet e tjera dhe njerëzit e tjerë, kemi hapësirë për të medituar mbi jetën dhe për të zbuluar gjëra të mëdha.

Megjithatë, Schopenhauer e dinte se jo të gjithë ndihen ose mund të ndihen kështu. Të gjithë jemi ndonjëherë të vetmuar. Në qytetet e zhurmshme, apo edhe në shëtitjet më të qeta jashtëtyre, mund të jemi të vetëdijshëm për mungesat në jetën tonë. Vetmia është si të shohësh një vrimë.

Është ndjenja e mungesës. Dhe ajo që na ofron Schopenhauer është një ndryshim këndvështrimi. Të qenit vetëm me mendjen tonë, është një mundësi për të kaluar kohë me veten. Është një vend lirie dhe ndershmerie, ku mendimet tona mund të shkojnë kudo që duam. Ne mund ta teletransportojmë

veten në një botë magjike, të rijetojmë një kujtim të lumtur apo të filozofojmë mbi realitetin. Është një bekim të flasësh me veten dhe mund të habitesh nga ajo që mëson. Në rrëmujën e ngarkuar të jetës sonë, ka shumë pak mundësi për të përfaquar llojin e vetmisë që vlerëson Schopenhauer.

Ne nuk mund të presim autobuzin në stacion, të shkojmë në tualet ose të presim në radhë, pa ndjerë nevojën për të bërë diçka. Momentet e qeta dhe të vetmuara janë të mbushura me zhurmë, që të mos kalojmë shumë kohë me veten. Dhe Schopenhauer ka të drejtë kur thotë se ne humbim diçka në këtë aspekt.

Sipas studimit të Bouker, tërheqja e vetëdijshme dhe e qëllimshme nga ndërveprimi shoqëror (pra të qenit vetëm dhe jo të vetmuar) lidhet me rritjen e kreativitetit. Siç thotë Bouker

"Gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës, ideja është që nëse po e largoni veten shumë nga bashkëmoshatarët tuaj, atëherë efektet negative të shmangies dhe distancimit nga bashkëmoshatarët".

Ne jemi mësuar që në moshë të re se shoqërueshmëria me të tjerët është një gjë e mirë, se qëndrimi midis turmës nxit lumturinë, dhe se përkatësia dhe përmbushja

vijnë nga marrëdhëniet sociale. Sigurisht, kjo bart shumë të vërteta. Por ajo që na jep qenia në shoqëri në një fushë, na privon tek një tjetër.

Kur marrim kohë për të qëndruar me veten, i japim vetes hapësirë për të imagjinuar. Kur mendja jonë nuk bombardohet vazhdimisht me përmbajtje, ajo mund të krijojë. Majkell Herris e shpreh shumë këtë në librin e tij "Të qenit vetëm: Në ndjekje të një jete personale në një botë turmash", në të cilën ai shkruan: "Deri pak kohë më parë, ka pasur momente të ditës kur ngarkesa pakësohej dhe ritmi i jetës ngadalësohej. Ju do ta gjeni veten vetëm, të ndarë nga miqtë dhe kolegët, dhe do të fokusoheshit tek mendimet tuaja. Momente të tilla mund të provokonin ndjenja vetmie dhe mërzie. Por po ashtu ofronin mundësi për të shfrytëzuar idetë, perceptimet dhe emocionet e paarritshme për veten nëse do të ishin në shoqërinë e të tjerëve".

Për shumë njerëz, nuk ka gjë të tillë si qëndrimi vetëm që përshkruan Schopenhauer, Harris dhe Bouker. Për këta njerëz, të qenit vetëm është e frikshme dhe e tmerrshme. Ndërsa vetmia mund të jetë ndonjëherë e nevojshme për krijimtarinë, ajo mund të jetë shpesh terreni i errët dhe pjellor i depresionit.

Samuel Xhonsen, giganti letrar dhe një njeri depresiv, kishte shumë frikë nga qëndrimi vetëm. Këshilla e tij më e mirë për ata që kishin një prirje të ngjashme melankolike si ai ishte: "Nëse jeni një bjerraditës, mos qëndroni vetëm; nëse jeni të vetmuar, mos rrihi kot, bëni diçka".

Ekulibri midis vetmisë dhe vetmisë është shumë delikat. Nuk ka asnjë mënyrë të sigurt për t'i dalluar të dyja. Të qëndruarit vetëm është shpesh një gjendje e zgjedhur prej vetë personit, ndërsa vetmia është e detyruar. Por edhe kjo është e komplikuar nga depresioni. Tërheqja me vetëdije nga shoqëria dhe marrëdhëniet sociale, është një sinjal tipik për shfaqjen e depresionit.


Vendimet e lindura nga problemet e shëndetit mendor mund të "zgjidhen", por nuk janë më të mirat për t'u marrë. Tek e fundit, mënyra e vetme për të dalluar të qëndruarit vetëm nga vetmia, është ta analizoni veten tuaj në përmasat më intime.

Disa njerëz mund ta bëjnë këtë me fuqinë e introspeksionit të tyre, por të tjerët kanë nevojë për ndihmë. Biseda, me miqtë, familjen apo një terapist, është ajo që e kthen vëmendjen te vetja. Pikërisht nën këtë dritë mund të shohim se sa shumë lulëzojmë vërtet duke qëndruar vetëm. / Big Think – Bota.al



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

SPORT



Distria Krasniqi e pesta në Kampionatin Botëror

PRISHTINË, 8 MAJ - Distria Krasniqi (-52 kg) e pesta në Kampionatin Botëror për Senior në Doha, Katar 2023. Garuesja e Kosovës në raundin e parë ishte e lirë, kurse në raundin e dytë ajo mposhti me Ippon në

vazhdime gjermanen, Mascha Ballhaus. Në raundin e tretë, kampionia olimpike mposhti me tri dënime për Ippon belgen, Amber Ryheul. Krasniqi në çerekfinale mposhti me Ippon edhe koreanen Seyun Jang. Distria

në gjysmëfinale u takua me japonezen, kampionen aktuale olimpike në këtë kategori, Uta Abe, nga e cila humbi me dy Wazaari për Ippon. Pas asaj ndeshje ajo u kualifikua të ndeshje në repasazh, pas një ndeshje të

gjatë prej 8 minutash në vazhdime humbi me Wazaari nga nënkampionia olimpike nga Rio 2016, italiania Odette Giuffrida. Ndërsa nesër garat i vazhdojnë Nora Gjakova (-57 kg), Akil Gjakova (-73 kg) dhe Flaka Loxha (-57 kg).



Reali përballet me Cityn

"Epoka e re"

MADRID, 8 MAJ - Gjysmëfinalja e parë e Ligës së Kampioneve zhvillohet sonte (e martë) në mes të Real Madridit dhe Manchester Cityt. Kjo përballje për shumë njohës të futbollit është edhe një finale e parakohshme në ligën më të fortë të futbollit në botë. Kampionët në fuqi të Realit shënuan katër gola në çerekfinale të Ligës së Kampioneve ndaj Chelseat dhe nuk pranuan asnjë gol, duke konfirmuar fuqinë që ka ky klub në këtë garë. Në anën tjetër, edhe Pep Guardiola me Cityn treguan fuqinë ndaj

FORMACIONET E MUNDSHME:

Real Madrid: Courtois; Carvajal, Rudiger, Alaba, Camavinga; Valverde, Kroos, Modriq; Rodrygo, Benzema, Vinicius Jr.

Manchester City: Ederson; Walker, Dias, Akanji; Stones, Rodri; Silva, De Bruyne, Gundogan, Grealish; Haaland.

Bayern Munchenit, duke e eliminuar me rezultat të përgjithshëm 4-1. Reali e fitoi Kupën e Mbretit, por tashme e ka të humbur garën për titull në La Liga, sepse Barcelona është bindshëm e para. Ky dështim në kampionat do të jetë një motiv më i madh për "mbretërit" ta kërkojnë kurorën e 15 në Ligën e Kampioneve, por kjo s'do të jetë aspak e lehtë për faktin se

City është duke shkëlqyer në këtë edicion dhe është në garë për "tripletën". Këto dy skuadra janë përballur edhe në edicionin e kaluar. City fitoi me shtatë gola në "Etihad" (4-3), por Reali e përmbysi duke fituar në ndeshjen kthyesë në "Bernabeu" me rezultat 3-1. Mungesat e Realit në këtë ndeshje janë Militao dhe Mendy, kurse Cityt pritet t'i mungojë Nathan Ake.



Ademi takohet me përzgjedhësin Giresse, paralajmërojnë fitore në ndeshjet e qershorit

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të hënën është takuar me përzgjedhësin Alain Giresse dhe ekipin e tij të Përfaqësueses së Kosovës. Gjatë takimit ata kanë diskutuar rreth përgatitjeve të përfaqësueses për dy ndeshjet e ardhshme kualifikuese për "Euro 2024", që do të zhvillohen në muajin qershor. "Në këtë takim ata janë shprehur të motivuar për dy ndeshjet kundër Rumanisë e Bjellorusisë dhe kanë shfaqur besimin e tyre të madh se do të arrijnë fitore në këto ndeshje. Kryetari Ademi dhe përzgjedhësi Giresse kanë pohuar se futbollistët janë në



formë të mirë dhe kanë shprehur besim të madh në potencialin e tyre. Ata kanë theksuar se ky është një moment i rëndësishëm për futbollin e Kosovës dhe se do të punojnë fort për ta arritur objektivin e kualifikimit për herë të parë në histori në

Kampionatin Evropian", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ky takim njëherësh vë në pah rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit para ndeshjeve të tilla dhe dëshmon angazhimin e përbashkët për ta përfaqësuar Kosovën me dinjitet në arenën ndërkombëtare.

Bajraktaraj shpallet kampion i Evropës, Krasniqi nënkampion

PRISHTINË, 8 MAJ - Kushtrim Bajraktaraj është shpallur kampion i Evropës në kategorinë -85 kg të Kampionatit Evropian në Bodybuilding dhe Fitness, që është mbajtur në Santa Susanna të Spanjës. Sukses të madh arriti edhe Betim Krasniqi, që u shpall nënkampion në kategorinë -75 kg. Flamur Rexhaj doli i katërti në -100 kg, ndërsa Granit Kuleta i gjashti në -95 kg. Komiteti Olimpik i Kosovës i përgëzon



garuesit tanë të bodybuildingut dhe të Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnessit të Kosovës për suksesin e arritur.

Sali Maxhera e Luna Goncalves, më të mirët e turneut final të Kupës

MITROVICË, 8 MAJ - Kapiteni i Trepçës, Sali Maxhera dhe fundorja e Istogut, Tainara Luna Goncalves, kanë fituar çmimet MVP në turneut final të Kupës së Republikës së Kosovës në hendboll. Pivoti Maxhera është shquar me

angazhim si në mbrojtje ashtu edhe në sulm. Ka krijuar hapësirë për bashkëlojtarët, ka punuar në mbrojtje dhe ka shënuar gola në çastet vendimtare, si në gjysmëfinale ndaj Prishtinës ashtu edhe në finale ndaj Besa Famgasit. Të

kujtojmë që finalja është vendosur vetëm pasi janë gjuajtur nga 11 penallti. Ishte finalja bindshëm më dramatike dhe më interesante në vitet e fundit. Ndërkohë brazilianja Luna Goncalves vazhdon të shquhet tek

Istogu. Skuadra istogase ka fituar thellë në gjysmëfinale ndaj Ferizajt, po ashtu në finale ndaj Vushtrrisë. Luna Goncalves ka dalë në skenë kur është dashur ta bëjë dallimin dhe e



ka ndihmuar Istogun që ta fitojë Kupën e Kosovës për herë të pestë.

Dellova, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 8 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 33-të në elitë i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Lumbardh Dellova. Komisioni vlerësues u pajtua që epiteti i "Yllit të javës" t'i jepet mbrojtësit të FC

Ballkani, pasi në ndeshjen kundër Dritës ishte i pakalueshëm në mbrojtje si dhe në fund shënoi golin vendimtar, që ua solli fitoren portokallezinjve (2:1) dhe i la në garë për titullin e kampionit. "Kjo është hera e parë që shpallëm 'Ylli i javës' dhe është kënaqësi e madhe, sidomos për

faktin që unë vij nga reparti i mbrojtjes dhe kam arritur të jem më i miri në xhiron e 33-të në Albi Mall Superliga. Fitorja e djeshme ndaj Dritës është shumë e rëndësishme për ne, ngaqë tani jemi barazuar me pikë me Dritën dhe tri ndeshjet e radhës do të jenë tri finale për ne. Falënderoj shumë

bashkëlojtarët dhe stafin teknik për mbështetjen që na japin dhe punën që e bëjmë bashkërisht. Besoj se Ballkani do të arrijë ta mbrojë titullin kampion dhe më pas na pret një punë e madhe në ndeshjet e Evropës për ta ripërsëritur suksesin e vitit të kaluar", ka thënë Dellova.



Palokaj plandos afganin Byat, mbron shiritin We Love MMA në Hanover

Hanover, 8 maj - Luftëtari shqiptar me prejardhje nga Prizreni, Gjoni Palokaj, e ka mundur me KO në raundin e parë garuesin nga Afganistani, Amir Shah Bayat. Palokaj në luftën në kafaz në tetor 2022 ka marrë titullin We Love MMA në Hamburg, ndërsa të shtunën në orët e vona ai e mbrojtë atë, duke fituar me KO ndaj afganit Bayat. Në Hanover salla ishte e stërbushur (5.000 tifozë), aq sa edhe kapaciteti i saj nuk përmbushi kërkesat për këtë meç. Palokaj, që është nga Velezha e Prizrenit, asnjëherë nuk harron prejardhjen dhe fitoren ua ka dedikuar bashkëkombësve. "Fitoren ua dedikoj bashkëkombësve të mi. Ata gjatë gjithë karrierës, me praninë e tyre dhe mbështetjen e perezervë, po më japin krahë. Andaj, fitoren ua dedikoj atyre", ka thënë Palokaj pas fitores dhe mbrojtjes së titullit. "Fitorja për mua është edhe më e madhe ngase në vitin 2018 kisha



humbur me pikë nga ky boksier", ka shtuar Palokaj. Lidhur me të ardhmen, ai ka thënë se në qershor të këtij viti udhëton në Amerikë në garën Top Ten në Miami. "Nuk do të ndalem deri në ligat më të forta si UCF, Bellatour e ligat më të mëdha në botë", ka pohuar Palokaj. 28-vjeçari nga Prizreni është student i inxhinierisë

elektroteknike. Ka përfunduar nivelin bachelor, që i bie se krahas sportit synon ngritje profesionale edhe në fushën e inxhinierisë. Gjoni punon edhe me të rinjtë, për t'ua mësuar zejen që vetë e praktikon në "Fghtschool Hannover", që është ndër shkollat më të mëdha në Gjermani, ku trajner e pronar është David Palokaj.

Hardeni i dhuron sërish fitoren Philadelphias, Durant-Booker të papërmbajtshëm ndaj Denverit

Boston, 8 maj - Philadelphia barazon 2-2 serinë e ndeshjeve gjysmëfinale ndaj Bostonit, pas fitores me rezultat 116-115 në sfidën e katërt. Një ndeshje e vendosur pas kohës shtesë, ku vendasit arritën të bëjnë një



KONFERENCA E LINDJES, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Boston - Philadelphia 115-116 (2-2)
New York - Miami (1-2)

KONFERENCA E PERËNDIMIT, "PLAY-OFF" - GJYSMËFINALE

Denver - Phoenix 124-129 (2-2)
Golden State - Lakers (1-2)

paraqitje të mirë. Sërish është James Hardeni protagonist i fitores, duke realizuar 42 pikë, përfshirë edhe koshin e fitores në fundin e takimit, mbështetur edhe nga Joel Embiid me 34 pikë e 13 rebounde. Për Bostonin, të gjithë titullarët realizuan mbi 10

pikë, por që s'mjaftuan për ta fituar ndeshjen. Në Konferencën e Perëndimit, ekipi i Phoenixit i shfrytëzoi në maksimum dyndeshjet e luajtura në fushën e tij, duke i fituar të dyja. Suns mundi me shifrat 129-124 Denverin, duke barazuar 2-2

serinë e gjysmëfinaleve. Nikola Jokiqi realizoi 53 pikë e 11 asistime për Denverin, por që mbetën për statistikë. Në kahun tjetër, Kevin Duranti e Devin Bookerit realizuan nga 36 pikë secili, duke i dhuruar fitoren skuadrës së Phoenixit.

SHKURT

Khaka dënohet me tetë ndeshje

Taulant Xhakës i ka kushtuar shtrenjtë veprimi josportiv që e bëri në fundjavë në derbin në mes të Baselit dhe Zurichut. Futbollisti u ndëshkua me karton të kuq pasi e goditi me kokë në gjoks lojtarin kundërshtar në "stulin Zidane". E me këtë rast, të hënën përfaqësuesi shqiptar e mori një dënim të rëndë nga Federata Zvicerane e Futbollit, duke u dënuar me tetë ndeshje. Atij nuk i mjaftoi kërkimfalja për veprimin e bërë.

Perezi: Vinicius është lojtari më i mirë në botë në pozicionin e tij

Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, e ka vlerësuar maksimalisht futbollistin brazilian Vinicius Junior pas fitimit të Kupës së Mbretit. "Ai është lojtari më i mirë në botë në pozicionin e tij. Ne duhet të mbrojmë lojtarët të veçantë si Vinicius", ka deklaruar Perez. Sipas medieëve spanjolle, këto fjalë janë edhe një paralajmërim për Mbappen, i cili, nëse dëshiron të shkojë në Spanjë, do t'i duhet të bëjë hapin e parë. Ato raportojnë se "Los Blancos" nuk është u gatshëm të çmendet për francezin pasi e ka dyshen Vinicius - Rodrigo të cilët po shkëlqejnë.

Leclerc: Duhet ta pranojmë faktin se po na parakalojnë të gjithë

Gara e Bakus një javë më parë duket sikurse thjesht një "flakë kashite" për Ferrarin, pasi makina italiane u rikthye te problemet e fillimsezonit. Një vend i pestë dhe një vend i shtatë në garën e Majemit zhvilluar të dielën nxorën edhe një herë në pah problemet që ka "kokëkuqja". "Kemi shumë për të punuar. Kemi një makinë që në kushte ideale në një paraqitje të mirë, por sapo dalim nga ato kushte makina bëhet e vështirë për t'u pilotuar. Me gomat e mesme nuk arrija dot ta pilotoja makinën dhe duhet t'i menaxhoja ato, ndërsa me gomat e forta gjërat shkuan disi më mirë", ka thënë Leclerc. "Në provat zyrtare duelojmë dhe jemi të shpejtë, por kur vjen puna për garën, jemi të avashhtë. Duhet ta pranojmë faktin se do të na parakalojnë gjithnjë e më shumë edhe pse kjo është e vështirë për t'u pranuar. Gjithsesi, nuk heqim dorë dhe shpresoj që modifikimet të na ndihmojnë", ka shtuar Leclerc, i shtati në Majemi.

Mourinho, favorit për ta marrë drejtimin e PSG-së

Në Paris kanë nisur punën për ta gjetur pasuesin e Christophe Galtier, me këtë të fundit që e pret shkarkimi i sigurt. Në tavolinën e sheikut Al-Khelaifi janë disa opsione, por kohët e fundit po fiton shumë kuota Jose Mourinho. Sipas "Rmc Sport", drejtori sportiv i klubit, Luis Camps, ka folur me agjentin e portugezit, për të kuptuar nëse ekziston mundësia që Mourinho të transferohet në Paris. Kjo është nga të paktat raste ku përfaqësues të klubit francez kanë kontaktuar direkt me trajnerë, apo agjentë të tyre. Një pikë e fortë në këto negociata është Jorge Mendes, agjenti i Mourinhos, në të njëjtën kohë është edhe agjenti i disa lojtarëve të PSG-së. Gjithnjë sipas "Rmc Sport", Mourinho është i pëlqyeri i Luis Camps. Ndryshe nga drejtori sportiv i klubit, presidenti Al-Khelaifi ka ëndërr Zinedine Zidane, por tratativa me Zidanin është shumë komplekse. Nëse zgjedhja e trajnerit të ri do të ishte në dorë të drejtorit sportiv, atëherë Mourinho është me një këmbë në Paris.

Spalletti: Besova te titulli, është një ngjarje historike

Trajneri i Napolit, Luciano Spalletti, ka dhënë një intervistë për mediet italiane për fitoren e titullit në Serinë A. Tekniku theksoi se besoi te triumfi, ndërsa më tej shtoi se

edhe nëse nuk do t'ia kishin dalë ta siguronin titullin ishte i kënaqur me rrugëtimin e bërë. "Titulli i Napolit është një ngjarje historike. Një ngjarje nga e cila të gjithë të

brendshëm ose jo përfitojnë, në përgjithësi i gjithë futbollin ynë. Nuk pushova asnjë moment së besuari te triumfi, por edhe sikur të mos e kisha fituar do të isha i kënaqur me

rrugëtimin. U ndjeva i pushtuar nga ndjenjat e tifozëve të Napolit. Në këtë moment ndihem i kënaqur, i lumtur, i qetë që u kam dhënë kaq shumë lumturi tifozëve të

Napolit. Kjo është lumturi e vërtetë, të kesh bërë kaq shumë njerëz të lumtur, duke u dhënë gëzim të gjithë atyre që e duan Napolin", ka thënë Spalletti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 390/1
 Datë: 08/05/2023

Agjencia e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës Qendra e Kompetencës në Skenderaj shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendra e Kompetencës në Skenderaj, në Republikën e Shqipërisë.

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjencionet turistike duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfor dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Durrës (prej 22 maj deri 26 maj 2023).
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës.
- Agjencioni do të na ofroj dëshmi (deklaraten nën betim nag OE), se do ti mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturore-historike.
- Agjencioni do të na ofroj dëshmi (deklaraten nën betim nag OE), në hotel dhe gjatë vizitave në monumentet kulturore-historike.
- Agjencioni do të ofroj dëshmi për qarkullimin financiar nga ATK-ja në tri vitet e fundit (2020,2021,2022)
- Agjencioni duhet të ofroj një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të posedojë referencat nga organizimet e llojit të njëjtë në të kaluarën.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt.22.05.2023 dhe kthimi më dt.26.05.2023.
- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.
- Në të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.
- Hoteli të posedojë sallë për ballo
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturore historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).
- Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër, Berat, Vlorë.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Agjencinës AAAPARr-së në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve dhe numri
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutjes do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në AAAPARr në të njëjtën ditë.

Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuara ti dorëzojnë në Agjencinë e AAAPARr-së në Prishtinë rruga "Agim Ramanadani" ndërtesa MASH II kati i tretë, gjatë orarit zyrtar 08:00-16:00.

Hapjen e ofertave e bënë Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2016.

Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjencionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotëson kriteret e caktuara nga KDSH-ja.

Agjencia e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës.

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Vërejtje: Secili ofertues duhet të aplikojë vetëm me një ofertë

Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet po atë ditë në ora 14.00h në zyrën Qendrore të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Geka Group" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811591230 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Geka Group" L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811591230 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Geka Group" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811591230 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artan Gugushka shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Blerta Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - V shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- "True Choice" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit ,e nr 810171215 si dhe certifikatën e TVSH-së, 330492512.

- Ajmane Shala shpall te pavlefshme diplomën e "Kolegjit Fama".

- Elheme Sinani shpall te pavlefshme 4 dëftesat e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- HALIME ISLAMI, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit te pare dhe te dyte te shkollës se mesme "HASAN PRISHTINA".

- BAHRIJE MUSA, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 8 të shkollës fillore "OSMAN RAMA".

- GEZIM RRUSTEMI, shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme "XHELADIN DEDA".

- Leotrim Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 10-të të lëshuar nga SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Drejton Gjoshi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I,II,III,të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Ligj Buqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Fidan Sokoli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Muhamet Ahmeti, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- Sabri Abazi, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme QSHT "Boris Kidric", Shkolla e re "Arkitekt Sinani".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professional



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, vendimit të Këshillit Drejtues me Nr.Prot.506 të datës 07.04.2023 dhe mbështetur në Rregulloren Organizimi i Shërbimit Profesional Administrativ të OIK-ut, OIK shpallë këtë:

KONKURS

Për këto pozita të punës:

I. Titulli i vendit të punës: Zyra për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombtarë

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Kryetarit të OIK-ut
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Kordinon menagjimin, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve;
- Ofron asistencë teknike për planin e aktiviteteve të projektit;
- Përgjegjës për të menagjuar të gjitha aspektet e ciklit të projektit duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin, dhe vlerësimin;
- Merr pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e projekteve;
- Prezenton projektin tek palët e interesit dhe bashkëpunon ngushtë me institucione ku shtrihet projekti;
- Identifikon përfituesit potencial në bashkëpunime me partnerët;
- Merr pjesë në hartimin e kontratave dhe marrëveshjeve të dalura nga nevojat e projekteve dhe nga aktivitetet me marrëdhënie ndërkombtare;
- Organizon trajnime dhe aktivitetet tjera të parapara me projekte për përfituesit e projektit;
- Përgatit raporte për secilin aktivitet/projekt, sipas kërkesës së mbikqyrësit të drejtëpërdrejtë;
- Sigurohet që raportet narrative të projektit të përgatiten dhe dorëzohen në kohë duke marrë parasysh kërkesat e raportimit nga donatorët;
- Përcjell dhe përgatit të gjitha termat e referencës për ekspertët lokal dhe ndërkombtarë;
- Mbikqyrë angazhimin e ekspertëve lokal dhe ndërkombtarë krahas termave të referencës;
- Ndjekë/Monitoron progresin e përditshëm të aktiviteteve të projektit, në krahasim me aktivitetet e planifikuara të punës si dhe objektivat e përgjithshme të projektit;
- Sigurohet që kontratat me donatorë të menaxhohen në përputhje me termat e tyre të referencës;
- Bënë monitorimin e shpenzimeve të aktiviteteve dhe zbatimin e buxhetit në përpikmëri;
- Sigurohet që buxheti të respektohet në mënyrë strikte;
- Përgatit, përditëson, publikon, dhe shpërndan dokumentacionin e projektit;
- Mbështet ekipet e projekteve, në të gjithë protofolin e punës nga fillimi i projektit deri në mbylljen për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e projektit;
- Bashkëpunon në programin e EVP-së të profilizuar në harmoni me standartet Europiane;
- I përgjigjet Kryetarit të OIK;

Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Diploma e Fakultetit
- ✓ 2 (dy) vite përvojë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

II. Titulli i vendit të punës: Zyrtarë administrativ për anëtarësim, licencim dhe rilicencim:

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
Raporton: Kryetarit të OIK-ut
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Pranimi i kërkesave për anëtarësim, regjistrim, licencim dhe rilicencim;
- Organizimi i takimeve të Komisioneve të lëmvë të ndryshme për shqyrtim të aplikacioneve të ndryshme;
- Mbajtja e Procesverbaleve;
- Përgatitja dhe procedimi i licencave dhe akteve tjera pas aprovimit të komisionit;
- Regjistrimi i fletëpagesave (të hyrave) të taksave për shërbimet e kryera;
- Barazimet me raportet e bankave;
- Lëshimi i akteve dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së anëtarëve të odës të cilët janë nën përgjegjësit e Zyrës;

Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Diploma e Fakultetit
- ✓ 1 (një) vit përvojë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

III. Titulli i vendit të punës: Zyrtarë administrativ për anëtarësim, licencim dhe rilicencim:

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)
Kontrata: Me periudhë të caktuar, (zëvendësim pushim i lehonisë)
Raporton: Kryetarit të OIK-ut
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Pranimi i kërkesave për anëtarësim, regjistrim, licencim dhe rilicencim;
- Organizimi i takimeve të Komisioneve të lëmvë të ndryshme për shqyrtim të aplikacioneve të ndryshme;
- Mbajtja e Procesverbaleve;
- Përgatitja dhe procedimi i licencave dhe akteve tjera pas aprovimit të komisionit;
- Regjistrimi i fletëpagesave (të hyrave) të taksave për shërbimet e kryera;
- Barazimet me raportet e bankave;
- Lëshimi i akteve dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së anëtarëve të odës të cilët janë nën përgjegjësit e Zyrës;

Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Diploma e Fakultetit
- ✓ 1 (një) vit përvojë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- ✓ Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- ✓ Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- ✓ Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurës:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrën e OIK-ut.

Adresa: Rruga "Holger Pedersen" mbraja QKUK-së kompleksi banesor Vëllezërit Asllani.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Prishtinë,

Datë: 08/05/2023



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË PULE

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues